

VENDIM
Nr. 40, datë 2.5.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS
OST SHA DHE “GEN – I TIRANA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, pikës 4.13 germa “A” pika 3, pikës 7 germa “g” të modelit të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike me nr. 1510/2 prot., datë 30.3.2012, midis OST sh.a. dhe “GEN–I Tirana” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate OST sh.a. dhe “GEN – I Tirana” sh.p.k., janë subjekte të licencuara nga ERE respektivisht me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.3.2009, për aktivitetin e transmetimit dhe me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 129, datë 2.12.2008, për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, modelin e tregut të energjisë miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008 “Rregullat e tregut”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 146 datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”.

- Modeli i tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë natyrë kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe “GEN–I Tirana” sh.p.k., me ndryshimet si më poshtë:

Pika 5.14 përpunohet si më poshtë:

Pika 5.14

Në rast kur “GEN–I Tirana” sh.p.k. nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST sh.a., ajo do të paguajë një kamatëvonesë mbi vlerën e faturës, të barabartë me 0.5 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonese, por jo më shumë se vlera e vetë faturës.

Pika 5.15 hiqet nga përmbajtja e marrëveshjes.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani